



Datë:13.12.2019

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare Nr.28/2008) neni 8 i Udhëzimit Administrativ Nr.05/14 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe procedurat për Pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 15, neni 65 i Statutit të Komunës së Klinës Nr.01-110-1232/110 të datës:07.04.2010, Vendimi i Kuvendit Komunal Nr.01-06-48530/19, dt 29.11/19, dënkohet.

NJOFTIM
PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK TË PROJEKTHARTËS
ZONALE TË KOMUNËS SË KLINËS 2020-2028



Me qëllim të inkurajimit të qytetarëve dhe të transparencës dhe të përmbushjes së detyrimeve ligjore, njoftojmë të gjithë të interesuarit se nga 20.12.2019 deri 20.01.2020, Komuna e Klinës do të zhvillojë Shqyrtimin Publik për draftdokumentin Harta Zonale e Komunës së Klinës 2020-2028.

Draftdokumenti i Hartës Zonale të Komunës së Klinës 2020-2028+ ka kaluar të gjitha fazat e parapara me ligjet në fuqi dhe paraqet rezultatin e një pune të përbashkët të profesionistëve të fushave të ndryshme dhe përfaqësuesve nga sektorët relevantë të Komunës së Klinës dhe Qeverisë së Kosovës.

Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, shqyrtimi publik zgjat 30 ditë, dhe gjatë kësaj periudhe, profesionistë, grupe të interesit dhe qytetarët e interesuar mund të dorëzojnë vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tyre në e-mailin zyrtar: web-faqen e Komunës së Klinës, si dhe tek grupi punues për pranimin dhe shqyrtimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve të bëra nga ana e personave fizikë dhe juridikë si dhe në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, kati I, objekti i Komunës së Klinës, Sheshi “Mujë Krasniqi” pn/.

Qëllimi i organizimit të shqyrtimit publik, si pjesë e procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës, është që të pranohen dhe vlerësohen komentet (vërejtjet dhe sugjerimet) të cilat shërbejnë për ngritjen e cilësisë së dokumentit, para dorëzimit të tij për miratim përfundimtar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në Kuvendin e Komunës.

Draftdokumenti i Hartës Zonale të Komunës së Klinës 2020-2028 është publikuar në Web-faqen: www.KomunaKline.Org, si dhe në sallën e konferencave, kati II, ndërtesa e Komunës së Klinës, Sheshi “Mujë Krasniqi” pn/

Njoftimi për Shqyrtim publik vendoset në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, në mjete të informimit (gazeta) dhe në web-faqen e Komunës së Klinës.

Me respekt



Kryetari
Zenun Elezaj